



Republika e Kosovës/Republika Kosova/Republic of Kosovo  
Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik  
Regulatorna Komisija Javne Nabavke  
Public Procurement Regulatory Commission



**KOMISIONI RREGULLATIV PËR PROKURIM PUBLIK**  
**PLANI I PËRFORMANCËS PËR VITIN 2023**

Nëntor, 2022

## Permbajtja

SHKURTESAT .....	3
1. Përmbledhje Ekzekutive .....	4
2. Hyrje .....	5
3. Përmbledhje e Objektivave .....	8
4. Ndikimi buxhetor .....	10
4.1 Të Hyrat dhe Shpenzimet .....	10
<b>B. Pjesa tabelare e Planit të Përformancës .....</b>	<b>11</b>

## SHKURTESAT

KRPP	Komisioni Rregullativ për Prokurim Publik
MFPT	Ministria e Financave Punës dhe Transfereve
USAID	Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar
EU	Bashkimi Evropian
BB	Banka Botërore
GIZ	Shoqata Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar
OECD	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik
SIGMA	Mbështetje për Përmirësim në Qeverisje dhe Menaxhim
AKK	Autoriteti Kosovar i Konkurrencës
KKPP	Këshilli Kombëtar për Prokurim Publik
OSHP	Organi Shqyrtues për Prokurim
AMB	Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar
DRr	Departamenti i Rregullave
DM	Departamenti i Monitorimit
DTI	Departamenti për Trajnime dhe Integrime
DPSE	Departamenti i Sistemit të Prokurimit Elektronik
DSHP	Divizioni i Shërbimeve të Përbashkëta
ZPMBNJ	Zyrtari Përgjegjës për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore
ZPP	Zyrtari Përgjegjës për Prokurim
ZPF	Zyrtari Përgjegjës për Financa
AP	Aktiviteti i Prokurimit
AK	Autoriteti Kontraktues
OE	Operatori Ekonomik
TEMF	Tenderi Ekonomikisht më i Favorshëm
KMI	Kosovo Municipality Integrity
AKK	Agjencia Kundër Korrupsionit
IKAP	Instituti i Kosovës për Administratë Publike

## 1. Përmbledhje Ekzekutive

Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (KRPP) në pajtim me nenin 30, paragrafi 8 të Ligjit Nr.06/l -113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, dhe Rregulloren (qrk) nr. 03/2020 për Performancën e Agjencive, dhe me qëllim të përmbushjes së mandatit të KRPP-së ka përgaditur planin e performancës së KRPP-së për vitin 2023 me përshkrime të objektivave, aktiviteve dhe treguesve/rezultateve të cilat synohen të arrihen gjatë vitit 2023.

Duhet theksuar që objektivat, aktivitetet dhe rezultatet e përfshira në këtë plan të performancës nuk kanë të bëjnë vetëm me fushën legjislative në sektorin e prokurimit publik në Kosovë, që është një nga mandatet ligjore kryesore që nga themelimi i KRPP-së, por kanë të bëjnë edhe me prokurimin elektronik i cili KRPP-në përveç mandatit rregullator të prokurimit që ka, e ka shndërruar edhe në ofrues të shërbimeve nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik, apo që nga viti 2016 KRPP operon dhe administron sistemin e prokurimit elektronik nëpërmjet të cilit zhvillohen të gjitha aktivitetet e prokurimit nga të gjitha autoritetet kontraktuese në Kosovë.

Plani i performancës së KRPP-së për vitin 2023 mbulon objektiva dhe aktivitete të cilat në përgjithësi synojnë:

- Avancimin dhe përditësimin e kuadrit ligjorë të prokurimit publik, me qëllim të harmonizimit me legjislacionin e ri ( Ligjin e ri të PP/Direktivat e EU-së) dhe të përdorimit të mjeteve elektronike (Prokurimit Elektronik);
- Zhvillimin dhe avancimin e mëtutjeshëm të prokurimit elektronik;
- Rritjen e efikasitetit në sistemin e Prokurimit Publik përmes vendosjes së rregullave dhe monitorimit të zbatimit të tyre si dhe siguroj zbatimin e parimit të transparencës dhe qasjes në informata në të gjitha fazat e aktivitetit të prokurimit gjatë përdorimit të fondeve publike.
- Ngritjen e kapaciteteve në prokurim publik nëpërmjet trajnimeve dhe edukimit të vazhdueshëm, dhe
- Rritjen e nivelit të transparencës në komunikim me publikun nëpërmjet veglave elektronike, programeve të ndërgjegjësimit dhe bashkëpunimit ndërinstytucional, përfshirë shoqërinë civile.

Për zbatimin e planit të performancës për vitin 2023, KRPP ka në dispozicion një buxhet total prej **935,153.00 €** (sipas KASH 2023-2025) dhe kryesisht mbështetet në kapacitetet/burimet njerzore ( departamenteve përkatëse) brenda KRPP-së dhe përkrahjen e donatorëve gjithashtu, përkrahje e cila është bërë në vazhdimësi dhe pritet që të vazhdojë edhe gjatë vitit 2023 ( ashtu siç është përshkruar më poshtë në këtë plan të performancës).

## 2. Hyrje

Komisioni Rregullativ për Prokurim Publik (KRPP) është themeluar në vitin 2004, sipas LPP Nr.2003/17. Aktualisht përgjegjësitë e KRPP-së rregullohen me Ligjin Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092.

Struktura organizative e KRPP-së është përcaktuar nga Bordi i KRPP-së, në bazë të përgjegjësiave dhe detyrave të përcaktuara me Ligjin për Prokurim Publik .

Në përputhje me Ligjin për Prokurim Publik, KRPP udhëhiqet nga Kryetari i Bordit të KRPP-së. Ndërsa Bordi është përgjegjës për miratimin e politikave, aprovon raportin vjetor të prokurimit publik për Kuvendin dhe Qeverinë e Kosovës, nxjerrë dhe aprovon rregullore në kuadër të legjislacionit sekondar për sistemin e prokurimit përkatësisht punës së KRPP-së.

Struktura themelore organizative e KRPP-së përbëhet nga Bordi, katër departamente, nëntë divizione.

- a. Departamenti i Rregullave (DRr)
- b. Departamenti i Monitorimit(DM)
- c. Departamenti për Trajnime dhe Integritet(DTI)
- d. Departamenti i Sistemit të Prokurimit Elektronik(DSPE)
- e. Divizioni i Shërbimeve të Përbashkëta (DSHP)
- f. Zyrtari Përgjegjës për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore(ZPMBNJ)
- g. Zyrtari Përgjegjës për Prokurim (ZPP)
- h. Zyrtari Përgjegjës për Financa (ZPF)

Në pajtim me LPP dhe përgjegjësitë që i jepen nga ky ligj, KRPP ka mandatin e rregullatorit në sektorin e prokurimit publik në Kosovë( përgaditja e kudrit ligjorë dytësorë, interpretimeve dhe opinioneve në prokurim publik, monitorimi i zbatimit të legjislacionit në prokurim publik, trajnimeve, etj), me aplikimin e prokurimit elektronik i është shtuar edhe mandati ofruesit të shërbimeve gjithashtu.

Prandaj edhe Plan i performancës i KRPP-së për vitin 2023, është përgaditur duke patur parasyshë zhvillimet e viteve të fundit dhe në varësi të nevojave/kërkesës për krijimin e një vizioni më të qartë për trendet e zhvillimit në fushën e prokurimit publik në aspektin legjislativ/rregullator dhe në aspektin e prokurimit elektronik gjithashtu.

Ky plan mbulon periudhën një (1) vjeçare, kryesisht duke renditur objektiva dhe aktivitete që do të zhvillohen, por edhe kërkesa ligjore dhe strategjike në fushën e prokurimit, krahas Strategjisë për Menaxhimin e Financave Publik dhe Planit të Veprimt të Strategjisë, pjese e se cilës është edhe prokurimi publik.

**Metodologjia** e cila është përdorur në hartimin e planit të performancës kryesisht është mbështetur në udhëzimet e Rregullores (qrk) nr. 03/2020 për Performancën e Agjencive, më saktësisht në procedurat për hartimin e planit të performancës së Agjencisë, duke filluar në formimin e grupit punues nga ana e menaxhmentit të KRPP-së, diskutimeve brenda departamenteve përkatëse të KRPP-së, grumbullimit të të dhënave për zhvillimet e viteve të fundit në sektorin e prokurimit publik, analizimin e raporteve vjetore të kontratave të nënshkuara në prokurim publik, konsultimin me donatorët potencial, etj.

Gjithashtu, në përgaditje të planit të performancës për vitin 2023 janë marrë parasysh edhe niveli i zbatimit apo arritjes së objektivave të planit të performancës së vitit 2022, Strategjia për Menaxhimin e Financave Publike (SMFP) 2022-2026 dhe raportet e institucioneve ndërkombëtare, siç janë raporti i EU-së, OECD, PEFA-s, etj, për vitet paraprake.

**Sfidat** në realizimin e objektivave dhe aktiviteteve të planit të performancës për vitin 2023 janë konsideruar gjithashtu nga KRPP gjatë përgaditjes së këtij plani. Dihet që Komisioni Rregullativ për Prokurim Publik, që nga themelimi me mandatin e vetëm të rregullatorit në fushën e legjislacionit në prokurim publik është përballur me sfida të ndryshme, e më së shumti në mungesë të kapaciteteve profesionale të brendshme për të përballuar dinamikën e ndryshimeve dhe reformave të kërkuara në fushën e prokurimit publik.

Tani, me aplikimin e prokurimit elektronik dhe mandatin e KRPP-së në fushën e prokurimit elektronik, mungesa e kapaciteteve profesionale, jo vetëm në fushën e prokurimit publik por edhe në fushën e TI-së do të jetë sfida më e madhe në realizimin e detyrave, obligimeve dhe përgjegjësi në raport me objektivat dhe aktivitetet e përfshira në planin e performancës për vitin 2023.

Duhet theksuar që sfida e mungesës së kapaciteteve bëhet edhe më e dukshme duke ditur që viteve të fundit dhe në vazhdimësi KRPP ballafaqohet me ikje të nëpunësve ( ekspertëve të prokurimit) me përvojë ( duke u angazhuar në projekte/institucione për një pagë më të mirë) dhe ekspertëve të TI-së të cilët gjithashtu pas përvojës së fituar në KRPP janë më atraktiv për sektorin privat ose institucionet ku paguhen më mirë.

Prandaj, duke ditur dinamikën e proceseve dhe zhvillimeve në sektorin e prokurimit publik që pritet të ndodhin gjatë vitit 2023 ( sidomos miratimi i Ligjit të ri të Prokurimit Publik dhe obligimet dhe përgjegjësitë që burojnë nga ky ligj për KRPP-në), mungesa e kapaciteteve/burimeve njerëzore do të jetë sfida kryesore në realizimin e objektivave të planifikuar në planin e performancës për vitin 2023.

Gjithashtu, përveç mungesës së burimeve njerëzore, sfida në realizimin e disa nga objektivave të planit të performancës për vitin 2023 do të jenë edhe varshmëria nga zhvillimet/proceset të cilat nuk janë në mandatin e KRPP-së, siç janë: miratimi i Ligjit të ri të Prokurimit Publik ( që është në mandatin e MFPT/Qeverisë dhe Kuvendit dhe nga i cili ligj varen shumica e aktiviteteve në kuadër të objektivit 1 dhe disa aktivitete që kanë të bëjnë me objektivin 2), avancimit të prokurimit elektronik në funksion të ndërveprueshmërisë me sisteme të tjera ( që është në varshmëri edhe të aktiviteteve që duhet implementuar nga institucionet/sistemet e ndërlidhura), etj.

Pra, sfida kryesore për KRPP-në realizim të objektivave dhe aktiviteteve në këtë plan të performancës do të jenë:

- mungesa e burimeve njerëzore të mjaftueshme dhe me ekspertizë në fushën e prokurimit publik dhe të TI-së në KRPP dhe
- varshmëria e aktiviteteve të parapara në këtë plan të performancës me aprovimin dhe kohën e hyrjes në fuqi të ligjit ri të prokurimit publik.

Nga hapat të cilët KRPP ka planifikuar të ndërmerr për të evituar sfidat e specifikuar më lartë, kryesisht kanë të bëjnë me tentime rreth angazhimit të stafit shtesë nëpërmjet procedurave të rekrutimit, ose angazhimit të ekspertëve për pozita specifike dhe me kohë të caktuar, dhe gjithashtu në një bashkëpunim dhe bashkërendim me projektet e përkrahura nga donatorët potencial, sic janë projektet e USAID, EU, BB, etj.

Bashkëpunimi dhe bashkërendimi i veprimeve me projektet e donatorëve, sidomos në përkrahjen me ekspert dhe ekspertizë, mbështetet në përkrahjen e deritanishme që ka përfituar KRPP nga donatorët dhe përkrahja që pritet të vazhdojë edhe në vitet në vijim.

Bazuar në bashkëpunimin që deri tani KRPP ka pasur me institucionet ndërkombëtare, si: USAID, EU, SIGMA, Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar (UK), Qeverinë e Luksemburgut, Banka Botërore dhe diskutimet aktuale me të gjitha këto institucione planifikohet që edhe gjatë vitit 2023 të vazhdohet bashkëpunimi dhe përkrahja konkrete në fushën e prokurimit publik nga komuniteti i donatorëve .

Objektiv kryesorë i mbështetjes dhe përkrahjes kryesisht do të jetë në ofrimin e asistencës dhe shërbimeve të konsulencës për ngritjen e kapaciteteve profesionale të KRPP-së dhe autoriteteve kontraktuese për përmbushjen e detyrave dhe ushtrimin e përgjegjësisë sipas Ligjit.

**Përkrahja nga EU:** EU nëpërmjet projektit për ndihmë teknike për mbështetjen e zbatimit të Reformave për Menaxhimin e Financave Publike në Kosovë (të implementuar nga GIZ), bazuar në planin e aktiviteteve të projektit edhe me tutje do të vazhdojë ofrimin e përkrahjes së asistencës teknike në fushën e legjislacionit primarë dhe sekondarë, në veçanti fokus do të jetë legjislacioni dytësor pas miratimit të Ligjit të Ri për prokurim publik.

Përkrahja nga Qeveria e Luksemburgut (KSV 019): Projekti Asistenca teknike në kontekst të integritetit evropian i zbatuar nga Zyra për Kriteria Ekonomike/Zyra e Kryeministrit dhe financuar nga Qeveria e Luksemburgut (KSV 019), ka për qëllim zhvillimin e kapaciteteve institucionale në administratën publike të Kosovës në përmbushjen e obligimeve që dalin nga MSA. Bazuar në planin e aktiviteteve të projektit edhe me tutje do të vazhdojë ofrimin e përkrahjes në zhvillimin e kapaciteteve të KRPP-së dhe në fushën e prokurimit publik në përgjithësi, përmes ofrimit të punëtorive/trajtimeve si dhe në përgatitjen e manualeve dhe udhëzimeve për sektorë të veçante në prokurim publik, që ndihmojnë një zbatim në mënyrë të duhur dhe sipas praktikave të mira evropiane të prokurimit publik.

**Përkrahja nga USAID:** Ashtu siç është theksuar në planin e performancës së vitit të kaluar, USAID me përfundim të projektit TEAM ka vazhduar përkrahjen për KRPP-në edhe gjatë vitit 2022 nëpërmjet projektit të ri KMI ( Kosovo Municipality Integrity) të implementuar nga DAI. Pikërisht për këtë përkrahje, KRPP në korrik të vitit 2022 ka nënshkruar Memorandum të Mirëkuptimit me KMI/USAID me qëllim të formalizimit të bashkëpunimit ndërmjet Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik dhe DAI/kontraktorit që zbaton Aktivitetin për Integritetin Komunal në Kosovë të financuar nga USAID-i. Në kuadër të mbështetjes së këtij projekti fokusi do të jetë në ngritjen e kapaciteteve në fushën e prokurimit në KRPP dhe AK-se, në mënyrë specifike mbështetjen me asistencë teknike dhe financiare në komponenten e prokurimit elektronik dhe monitorimit. Plani i aktiviteteve të cilat do të përfshihen në mbështetje nga projekti KMI/USAID aktualisht është në draftim dhe diskutim, dhe pritet që deri në fund të vitit të dihen saktë aktivitetet e KRPP-së të cilat do të mbështeten nga projekti i USAID për vitin 2023.

**Përkrahja nga Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar:** Edhe gjatë vitit 2023 koordinimi dhe përkrahja e KRPP-se do të përfshijë edhe bashkëpunimin me Ambasadën e Mbretërisë së Bashkuar (UK), me të cilët KRPP ka të nënshkruar një Memorandum Mirëkuptimi për implementim të projektit për avancim të modulit të OSHP-së brenda sistemit të prokurimit elektronik. Aktualisht avancimi i modulit të OSHP-së brenda sistemit të prokurimit elektronik

është në fazën testuese dhe sipas planifikimeve ky modul do të futet në përdorim në janar të vitit 2023. Rrjedhimisht përkrahja e projektit do të vazhdojë edhe gjatë vitit 2023 dhe ka të bëjë kryesisht me asistencën në fazat e trajnimit, përdorimit të funksionaliteteve të modulit dhe çfarëdo aktiviteti që është në funksion të vënies në përdorim të plotë të këtij moduli.

**Përkrahja nga donatorë të tjerë potencial:** Bazuar në bashkëpunimin dhe diskutimet aktuale me Bankën Botërore, potencialisht gjatë vitit 2023 mund të përfitohet përkrahje nga Banka Botërore në asistencë teknike/profesionale të vlerësimit të gjendjes aktuale në prokurim elektronik dhe jo vetëm, dhe sidomos në avancim të sistemit të prokurimit elektronik nëpërmjet projektit të BB i cili është në fazën përgatitore Projekti për Përforsimin e Qeverisjes Dixhitale për Ofrimit të Shërbimeve në Kosovë". Sidoqoftë, mundësia dhe niveli i përkrahjes është ende i pa definuar, prandaj këtë pjesë KRPP e trajton si potenciale për t'u siguruar.

### 3. Përmbledhje e Objektivave

Në përmbledhjen ekzekutive janë specifikuar objektivat e përcaktuara dhe përfshirë në planin e performancës për vitin 2023 dhe të cilët objektiva KRPP synon t'i realizoj për gjatë vitit 2023. Përshkrim më i detajuar i objektivave, me tregesit e performancës dhe aktivitetet e përfshira për secilin objektiv janë prezantuar në shtojcën tabelare më poshtë. Derisa në këtë pjesë do të ofrohet një përmbledhje për secilin nga objektivat e përfshirë në planin e performancës për vitin 2023.

**Objektivi 1:** Përditësimi dhe avancimi i kornizës ligjore të prokurimit publik

#### Aktivitetet:

- Analizë dhe vlerësim i nevojave për përditësim të kornizës ligjore, bazuar në: kërkesat për interpretim ligjor drejtuar KRPP-se, mangësitë e evidentuara nga monitorimi i KRPPse, zhvillimeve në prokurim elektronik dhe bazuar në kërkesat nga Ligji i ri i Prokurimit Publik pas aprovimit
- Plotësim-ndryshimi i Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik dhe i akteve tjera dytësore
- Rishikim dhe përditësim i pyetjeve të shpeshta –aktualisht të publikuara nga KRPP

**Objektivi 2:** Operim i qëndrueshëm dhe avancimi i sistemit të prokurimit elektronik

#### Aktivitetet:

- Administrim dhe mirëmbajtje e sistemit të prokurimit elektronik
- Analiza, përgaditja e specifikimeve teknike, zhvillimi, testimi dhe aplikimi i funksionaliteteve të reja;
- Analizë në aspektin teknologjik dhe ligjorë për avancim/modifikim të sistemit të prokurimit elektronik, përgaditja e TORs, zhvillimi aplikimi, testimi dhe vënia në përdorim e modifikimeve sipas ToR.
- Kontraktimi i punëve nga të dy institucionet (KRPP dhe MFPT) për ndryshimet/përditësimet në të dy sistemet, zhvillimi, testimi dhe implementimi i



ndryshimeve/përditësimeve për ndërlidhje të sistemit të prokurimit elektronik me sistemin e Thesarit

- Vënia në përdorim e modulit të avancuar të ankesave në kuadër të sistemit të prokurimit elektronik.

### **Objektivi 3: Avancim në monitorim të aktiviteteve të prokurimit dhe administrimit të menaxhimit të kontratave**

#### **Aktivitetet:**

- Monitorimi i njoftimeve të aktiviteteve të prokurimit publik dhe administrimit të menaxhimit të kontratave në kohë reale përmes platformës së e-prokurimit.
- Angazhimi i një eksperti me ekspertizë në fushën e monitorimit dhe analizës dhe përpunimit të të dhënave në prokurim publik

### **Objektivi 4: Ngritjen e kapaciteteve në prokurim publik nëpërmjet trajnimeve dhe edukimit të vazhdueshëm**

#### **Aktivitetet:**

- Vlerësimi i nevojave të AK-se dhe palëve të tjera për trajnim dhe certifikim në prokurim publik në pajtueshmëri me rregullat e reja për trajnime dhe kërkesave ligjore nën 25.1 LPP-se.
- Trajnime të dedikuara për zyrtarë të Autoriteteve Kontraktuese për aplikimin e kriterit të dhënies TEMF /MEAT.
- Trajnimi i zyrtarëve për përdorim të moduleve të menaxhimit të kontratës dhe vlerësimit të performancës.
- Organizimi i trajnimeve të dedikuara për zyrtarët/auditorët e Zyrës Kombëtare të Auditimit për përdorim të funksionaliteteve të prokurimit elektronik dhe aspektit ligjorë në prokurim publik
- Organizimi i trajnimeve të dedikuara për zyrtarë të PK- në përdorim të funksionaliteteve të sistemit të prokurimit elektronik

### **Objektivi 5: Rritjen e nivelit të transparencës në komunikim me publikun dhe bashkëpunimit ndërinstitucional, përfshirë shoqërinë civile.**

#### **Aktivitetet:**

- Angazhimi i një zyrtari për marrdhënie me publikun.
- Zhvillimi dhe publikimi i webfaqes së re institucionale për KRPP-në
- Aplikimi i rrjeteve sociale për prezantim të KRPP-së
- Organizim i takimeve të përbashkëta ndërinstitucionale dhe me shoqërinë civile

#### 4. Ndikimi buxhetor

Në përputhje me legjislacionin në fuqi, KRPP-ja është një agjenci jofitimprurëse dhe duke pasur parasysh këtë status, të ardhurat dhe shpenzimet e paraqitura në këtë Plan kanë për qëllim zgjerimin e të dhënave financiare për të ardhurat dhe shpenzimet e KRPP-së, por jo për rezultatet financiare, sepse është e qartë se KRPP-ja nuk është një organizatë fitimprurëse.

<i>Planifikimi i të hyrave për vitin 2021</i>	<i>Planifikimi i të hyrave për vitin 2022</i>	<i>Planifikimi i të hyrave për vitin 2023</i>
NA	NA	NA

##### 4.1 Të Hyrat dhe Shpenzimet

Buxheti i planifikuar i KRPP-së, sipas Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve, është si me poshtë.

	<i>Viti 2022</i>	<i>Viti 2023</i>	<i>Viti 2024</i>
<b>Totali</b>	<b>714,399.00 €</b>	<b>935,153.00 €</b>	<b>953,153.00 €</b>
<b>Nr. i punëtorëve</b>	42	45	45
<b>Pagat dhe Mëditjet</b>	360,146.00 €	399,900.00 €	399,900.00 €
<b>Mallrat dhe Shërbimet</b>	279,253.00 €	330,253.00 €	330,253.00 €
<b>Shpenzimet Komunale</b>	5,000.00 €	5,000.00 €	5,000.00 €
<b>Subvencionet dhe Transferet</b>	0.00	0.00	0.00
<b>Shpenzimet Kapitale</b>	70,000.00 €	200,000.00 €	200,000.00 €
<b>Burimet e Financimit</b>	Buxheti i Kosovës	Buxheti i Kosovës	Buxheti i Kosovës
<b>Grantet qeveritare</b>	0.00	0.00	0.00
<b>Të hyrat vetanake</b>	0.00	0.00	0.00
<b>Financimet nga huamarrjet</b>	0.00	0.00	0.00
<b>Grantet nga donatorët</b>	0.00	0.00	0.00

Duhet theksuar që në burimet e financimit nuk janë përfshirë burimet që do përfitohen nga përkrahja e donatorëve potencial, meqenëse në kohën e përgaditjes së planit të performancës nuk dihet ende për përkrahjet specifike që do të ofrohen. Nga diskutimet dhe konsultimet e dritanishme shumica e donatorëve presin aprovimin e Ligjit të ri të Prokurimit Publik në mënyrë që të dihet saktë rreth aktiviteteve në të cilat do të ofrojnë përkrahje, përfshirë nivelin e angazhimit dhe koston buxhetore gjithashtu për secilin angazhim.

**B. Pjesa tabelare e Planit të Përformancës**

Nr.	Objektivat, treguesit dhe detyrat	Vlera bazë	Caku			
I.	<b>Objektivi 1: Përditësimi dhe avancimi i kornizës ligjore te prokurimit publik</b>					
1	<b>Treguesi i përformances:</b> Legjislacion dytësor në pajtueshmëri me Ligjit të ri të Prokurimit Publik	X [2022]	Synohet pergaditja e legjislacionit të domosdoshëm për zhvillim të aktiviteteve të prokurimit.			
2	<b>Treguesi i përformances:</b> Rritja e numrit të pyetjeve të shpeshta, interpretimeve dhe opinioneve të publikuara për të gjitha palët e interesuara	X [2022]	Synohet një rritje prej 20% ne krahasim me vitin 2022			
Nr.	Aktiviteti	Drejtoria përgjegjëse	Afati i zbatimit	Buxheti	Burimi i financimit	Produkti
1.1	Analizë dhe vlerësim i nevojave për përditësim te kornizës ligjore, bazuar ne: kërkesat për interpretim ligjor drejtuar KRPP-se, mangësitë e evidentuara nga monitorimi i KRPPse, zhvillimeve ne prokurim elektronik dhe bazuar ne kërkesat nga Ligji i ri i Prokurimit Publik pas aprovimit	KRPP/Dep. i Rregullave (DRr), dhe potencialisht donatorët(BE)	K1-K4	S'ka implikime buxhetore të veçanta nga KRPP.	KRPP, Donatorët	Zhvillim i aktiviteteve të prokurimit në mënyrë me efikase dhe efektive; Rregulla dhe dokumente standarde te prokurimit publik te përshtatura me legjislacion primar dhe avancimet e prokurimit elektronik;
1.2	Plotësim-ndryshimi i Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik dhe i akteve tjera dytësore	KRPP/Dep. i Rregullave (DRr) dhe departamentet e tjera të KRPP	K1-K4	S'ka implikime buxhetore të veçanta nga KRPP.	KRPP	Ulje e kërkesave ne ofrim te interpretimeve për zbatimin e LPP dhe legjislacionit dytësor;

PLANI I PËRFORMANCËS PËR VITIN 2023

1.3	Rishikim dhe përditësim i pyetjeve të shpeshta – aktualisht të publikuara nga KRPP	KRPP/Dep. i Rregullave (DRr)	K1-K4	S'ka implikime buxhetore të veçanta nga KRPP.	KRPP	Pyetje të shpeshta të strukturuar në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe të strukturuar në interpretime dhe opinione
	<i>Buxheti i përgjithshëm për Objektivin 1:</i>			0		
<b>Nr.</b>	<b>Objektivat strategjike, treguesit dhe aktivitetet</b>				<b>Vlera bazë</b>	<b>Caku</b>
<b>II.</b>	<b>Objektivi 2: Operim i qëndrueshëm dhe avancimi i sistemit të prokurimit elektronik</b>					
1	<b>Treguesi i performances:</b> Funkcionim i vazhdueshëm dhe pa “down-time” i sistemit të prokurimit elektronik				95% [2022]	96%
2	<b>Treguesi i performances:</b> Funkcionalitete të reja të sistemit të prokurimit elektronik				X [2022]	Së paku dy funksionalitete
3	<b>Treguesi i performances:</b> Sistemi i prokurimit elektronik në pajtueshmeri me Ligjin e ri të PP				50% [2022]	Përkrahje e së paku 80% të ndryshimeve ligjore
4	<b>Treguesi i performances:</b> Sistemi i prokurimit elektronik i ndërveprueshëm me sisteme të tjera qeveritare				1 [2022]	Së paku edhe një(1) ndërveprim me sisteme qeveritare ( sistemin e thesarit)
5	<b>Treguesi i performances:</b> Dërgimi/pranimi dhe shqyrtimi i të gjitha ankesave nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik				70% (2022)	100%
<b>Nr.</b>	<b>Aktiviteti</b>	<b>Drejtoria përgjegjëse</b>	<b>Afati i zbatimit</b>	<b>Buxheti</b>	<b>Burimi i financimit</b>	<b>Produkti (Output)</b>

PLANI I PËRFORMANCËS PËR VITIN 2023

2.1	Administrim dhe mirëmbajtje e sistemit të prokurimit elektronik	KRPP/DSPE /Kontraktuesi	K1-K4	180,000€	KRPP	<p>Realizim i aktiviteteve te prokurimit nga ana e AK-se pa probleme dhe në kohë</p> <p>Pjesëmarrje e sigurt dhe e lehtësuar e OE në aktivitete të prokurimit, pa diskriminim dhe plotësisht transparent - Transparence dhe disponueshmeri në kohë reale e të dhënave të prokurimit për të gjitha palët e interesuara</p>
2.2	Analiza, përgaditja e specifikimeve teknike, zhvillimi, testimi dhe aplikimi i funksionaliteteve të reja	KRPP/ DSPE /Kontraktuesi	K1-K4	80,000 €	KRPP dhe potencialisht USAID	<p>Ndërfaqe e re ne sistemin e prokurimit elektronik (CMS) per t'a bere me shume "User friendly" dhe "mobile responsive", per te krijuar qasje me te lehte dhe me te përshtatshme per përdoruesit gjate përdorimit te sistemit te prokurimit elektronik.</p> <p>Automatizim te procesit te vlerësimit ne rastet e përdorimit te kriterit</p>

PLANI I PËRFORMANCËS PËR VITIN 2023

						<p>“tenderi me çmimin ekonomikisht me te favorshëm. Mundësimin e aplikimit te metodave/veglave te reja te prokurimit, siç është “Blerja Dinamike”</p>
2.3	<p>Analizë në aspektin teknologjik dhe ligjorë per avancim/modifikim te sistemit te prokurimit elektronik, përgaditja e TORs, zhvillimi aplikimi, testimi dhe vënia ne përdorim e modifikimeve sipas ToR.</p>	<p>KRPP/ DSPE /Kontraktuesi</p>	<p>K1-K4</p>	<p>120,000 €, me perfshirje te donatoreve</p>	<p>KRPP dhe potencialisht donatoret.</p>	<p>Sistem i prokurimit elektronik qe përkrahë zhvillimin e procedurave te prokurimit sipas ndryshimeve ligjore, sidomos ne aplikimin e vetë deklarimit, pragjeve te reja te prokurimit, aplikimin e kriterit “Çmimi ekonomikisht me i favorshëm” si kriter i dhënies, ndarjen e OB ne Autoritete kontraktuese dhe Entitete Kontraktuese, etj</p>

2.4	Kontraktimi i punëve nga të dy institucionet (KRPP dhe MFPT) për ndryshimet/përditësimet në të dy sistemet, zhvillimi, testimi dhe implementimi i ndryshimeve/përditësimeve për ndërlidhje të sistemit të prokurimit elektronik me sistemin e Thesarit	KRPP, MFPT dhe potencialisht donatorët (projekti KIM/USAID)	K1-K4	60,000€	KRPP dhe potencialisht donatorët (projekti KIM/USAID)	<p>Kontroll i automatizuar i disponueshmërisë së mjeteve dhe nevojave gjate inicimit të aktiviteteve të prokurimit nga ana e AK-se.</p> <p>Te dhëna të detajuara dhe në kohe reale për statusin e aktiviteteve të prokurimit për të cilat janë zotuar mjete financiare.</p> <p>Te dhëna të detajuara dhe transparente për statusin e kontratave në implementim dhe gjendjen e pagesave për kontratat të cilat paguhen nga buxheti i Kosovës .</p> <p>Përmirësim në të dhënat e kontratave shumëvjeçare në implementim – të dhëna të cilat shfrytëzohen për përgatitje dhe ekzekutim të buxhetit të Kosovës nga ana e MFPT.</p>
-----	--	---	-------	---------	---	--

PLANI I PËRFORMANCËS PËR VITIN 2023

2.5	Vënia në përdorim e modulit të avancuar të ankesave në kuadër të sistemit të prokurimit elektronik	KRPP, OSHP, Projekti i Ambasadës së UK	K1	S'ka kosto për KRPP-në		<ul style="list-style-type: none"> <li>· Përdorim i plotë i modulit të ankesave nga ana e OSHPse;</li> <li>· Të dhëna të detajuara dhe në format të lexueshëm për ankesat e dorëzuara dhe shqyrtuara;</li> <li>· Rritje e transparencës në të dhënat e ankesave të dorëzuara dhe shqyrtuara;</li> </ul>
	<b><i>Buxheti i përgjithshëm për Objektivin 2:</i></b>			<b>440,000€</b>		
<b>Nr.</b>	<b>Objektivat strategjike, treguesit dhe aktivitetet</b>				<b>Vlera bazë</b>	<b>Caku</b>
<b>III.</b>	<b>Objektivi 3: Avancim në monitorim të aktiviteteve të prokurimit dhe administrimit të menaxhimit të kontratave</b>					
1	<b>Treguesi i përformances:</b> Rritje e numrit të indikatorëve të rrezikut për t'u monitoruar aktivitetet e prokurimit				3(2022)	Se paku dy indikatorë të shtuar
2	<b>Treguesi i përformances:</b> Metodologji e re për monitorim, perpunim dhe analizim të të dhënave në prokurim publik.				0(2022)	1 (2023)
<b>Nr.</b>	<b>Aktiviteti</b>	<b>Drejtoria përgjegjëse</b>	<b>Afati i zbatimit</b>	<b>Buxheti</b>	<b>Burimi i financimit</b>	<b>Produkti</b>



3.1	Monitorimi i njoftimeve të aktiviteteve të prokurimit publik dhe administrimit të menaxhimit të kontratave në kohë reale përmes platformës së e-prokurimit.	KRPP/Dep. i Monitorimit	K1-K4	Ska implikime buxhetore	KRPP	<p>Ngritja e efikasitetit dhe efektivitetit të procesit të monitorimit nga KRPP.</p> <p>Rritja e përdorimit të modulit të menaxhimit të kontratave të AK dhe OE.</p> <p>Llogaridhënie e shtuar në prokurim publik nga ana e AK-së gjatë zbatimit të aktiviteteve të prokurimit nga AK me fokus zvogëlimi i procedurave pa publikim të njoftimit dhe aktiviteteve të prokurimit të anuluar.</p>
3.2	Angazhimi i ekspertëve në fushën e monitorimit dhe analizës dhe përpunimit të të dhënave në prokurim publik	KRPP/Dep. i Monitorimit	K1-K4	Nuk është përcaktuar	USAID/ KMI	<p>Monitorim i aktiviteteve të prokurimit i bazuar në metodologjinë e re.</p> <p>Identifikim i dobësive në fushën e prokurimit publik të cilat kërkojnë adresim nepermjet përmirësimeve në kornizën ligjore dhe vendimmarrjes.</p>

PLANI I PËRFORMANCËS PËR VITIN 2023

	<i>Buxheti i përgjithshëm për Objektivin 3:</i>			0		
<b>Nr.</b>	<b>Objektivat strategjike, treguesit dhe aktivitetet</b>				<b>Vlera bazë</b>	<b>Caku</b>
<b>IV.</b>	<b>Objektivi 4: Ngritjen e kapaciteteve në prokurim publik nëpërmjet trajnimeve dhe edukimit të vazhdueshëm</b>					
1	<b>Treguesi i përformances:</b> Rritja e numrit të zyrtarëve të certifikuar në prokurim publik				577(2022)	+20%(2023)
2	<b>Treguesi i përformances:</b> Rritja e numrit të zyrtarëve të AK-se të trajnuar në përdorim të veglave për menaxhim të kontratës				190(2022)	+40% (2023)
3	<b>Treguesi i përformances:</b> Rritja e numrit të zyrtarëve të AK-se të trajnuar në përdorim kriterit të dhënies TEMF /MEAT.				61(2022)	+50%(2023)
4	<b>Treguesi i përformances:</b> Auditorë nga Zyra Kombëtare e Auditimit të trajnuar në prokurim elektronik				0(2022)	120 (2023)
5	<b>Treguesi i përformances:</b> Zyrtarë të PK të trajnuar për përdorim të sistemit të prokurimit elektronik – për qëllime të hetimeve në aktivitete të prokurimit				0(2022)	20(2023)
<b>Nr.</b>	<b>Aktiviteti</b>	<b>Drejtoria përgjegjëse</b>	<b>Afati i zbatimit</b>	<b>Buxheti</b>	<b>Burimi i financimit</b>	<b>Produkti</b>
4.1	Vlerësimi i nevojave të AK-se dhe palëve të tjera për trajnim dhe certifikim në prokurim publik në pajtueshmeri me rregullat e reja për trajnime dhe kërkesave ligjore nën 25 të LPP-se.	KRPP/Departamenti i Trajnimeve / IKAP /	K1-K2	S'ka implikime buxhetore të veçanta nga KRPP.	Potencialisht aktivitetet në këtë objektive do të perkrahen nga IKAP	Plotësimi i nevojave të AKsë për zyrtarë të certifikuar në prokurim publik. Certifikimi i zyrtarëve sipas nënit 25 të LPP.

PLANI I PËRFORMANCËS PËR VITIN 2023

4.2	Trajnime për Autoritete Kontraktuese në pajtueshmëri me ndryshimet ligjore – aprovimit të Ligjit të ri të PP	KRPP/Departamenti i Trajnimeve/US AID	K3-K4	S'ka implikime buxhetore të veçanta nga KRPP.	Potencialisht aktivitetet në këte objektiv do të perkraken nga donatorët	Avancimi njohurive profesionale për Ligjin e Ri në fushën e PP. Kapacitete të mjaftueshme në AK për të zhvilluar aktivitete të prokurimit në pajtueshmëri me Ligjin e ri të PP.
4.3	Trajnime të dedikuara për zyrtarë të Autoriteteve Kontraktuese për aplikimin e kriterit të dhënies TEMF /MEAT.	KRPP/Departamenti i Trajnimeve/Divizioni i Integritetit/Zyra e Kryeministrit	K1-K2	S'ka implikime buxhetore të veçanta nga KRPP	Potencialisht aktivitetet në këte objektiv do të perkraken nga donatorët	Forcimi i kapaciteteve profesionale për aplikimin të TEMF në fushën e prokurimit publik.
4.4	Trajnimi i zyrtarëve të AK për përdorim të moduleve të menaxhimit të kontratës dhe vlerësimit të performances.	KRPP/Departamenti i Trajnimeve/AK	K1-K2	S'ka implikime buxhetore të veçanta nga KRPP	Potencialisht aktivitetet në këte objektiv do të perkraken nga donatorët	Forcimi i kapaciteteve profesionale për përdorim të moduleve të menaxhimit të kontratës dhe vlerësim të performances
4.5	Organizimi i trajnimeve të dedikuara për zyrtarët/auditorët e Zyrës Kombëtare të Auditimit për përdorim të funksionaliteteve të prokurimit elektronik dhe aspektit ligjorë në prokurim publik	KRPP/Dep.i Trajnimeve /IKAP	K1-K2	S'ka implikime buxhetore të veçanta nga KRPP	KRPP	Zyrtarë/auditorë të Zyrës Kombëtare të Auditimit të trajnuar për auditim të aktiviteteve të prokurimit

						nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik dhe në kohë reale. Rritje e efikasitetit të auditimit të aktiviteteve të prokurimit të zhvilluara nga të gjitha AK-se.
4.6	Organizimi i trajnimeve të dedikuara për zyrtarë të PK- në përdorim të funksionaliteteve të sistemit të prokurimit elektronik	KRPP/PK	K1-K3	S'ka implikime buxhetore të veçanta nga KRPP	KRPP	Përdorim dhe hetim i pavarur dhe në kohë reale i aktiviteteve të prokurimit nga ana e zyrtarëve të PK.
	<b>Buxheti i përgjithshëm për Objektivin 4:</b>			0		
<b>Nr.</b>	<b>Objektivat strategjike, treguesit dhe aktivitetet</b>				<b>Vlera bazë</b>	<b>Caku</b>
<b>V.</b>	<b>Objektivi 5: Rritjen e nivelit të transparencës në komunikim me publikun dhe bashkëpunimit ndërinstitucional, përfshirë shoqërinë civile.</b>					
1	<b>Treguesi i përformances:</b> Informim dhe publikim në kohë reale i të dhënave dhe zhvillimeve në prokurimit publik, përfshirë punën e KRPP-së.				Aktualisht vetem në e-prokurim(2022)	Web faqe e dedikuar institucionale për KRPP-në, përfshirë rrjetet sociale

PLANI I PËRFORMANCËS PËR VITIN 2023

2	<b>Treguesi i përformances:</b> Takime periodike të përbashkëta ndërinstitucionale dhe me shoqërinë civile				1(2022)	Së paku 2(dy) (2023)
Nr.	Aktiviteti	Drejtoria përgjegjëse	Afati i zbatimit	Buxheti	Burimi i financimit	Produkti
5.1	Angazhimi i nje zyrtari per marrdhenie me publikun	KRPP	K1-K4	Ska implikime buxhetore	KRPP	Rritja e informimit dhe transparences rreth punes dhe aktiviteteve te KRPP-se me publikun.
5.2	Zhvillimi dhe publikimi i webfaqes se re institucionale për KRPP-në	KRPP	K1-K2	Ska implikime buxhetore	KRPP	Web faqe e dedikuar institucionale për KRPP, e cila do të përdoret për të prezantuar punën e KRPP-së dhe të gjitha zhvillimet në fushën e prokurimit publik.
5.3	Aplikimi i rrjeteve sociale për prezantim të KRPP-së	KRPP	K1-K2	Ska implikime buxhetore	KRPP, USAID/KMI	Forcimi i marrdhenieve dhe komunikimit me publikun, përfshirë prezencë të shtuar publike e KRPP-së dhe zhvillimeve në fushën e prokurimit publik.
5.4	Organizim i takimeve të përbashkëta ndërinstitucionale	KRPP, OSHP, AKK, AKK, etj	K1-K4	1000,00	KRPP	Koordinim i shtuar në zbatim te kornizes ligjore

PLANI I PËRFORMANCËS PËR VITIN 2023

						ne fushen e prokurimit publik dhe mangësive të identifikuara nga institucionet relevante.
5.5	Organizim i takimeve të përbashkëta me shoqërinë civile	KRPP, Shoqëria Civile, Odat ekonomike, etj	K1-K4	1000,00	KRPP	Bashkepunim ne fushen e prokurimit elektronik dhe ne adresimin e mangësive të identifikuara nga shoqëria civile.
	<b>Buxheti i përgjithshëm për Objektivin 5:</b>			2000,00E		